

Informacion rreth taksave / tatimeve te zbatueshme

LIGJ Nr.9975, datë 28.7.2008 PËR TAKSAT KOMBËTARE I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës,

Ky ligj përcakton llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore të taksave dhe tarifave kombëtare, si dhe detyrimet që kanë agjentët e taksave dhe tarifave kombëtare. (Ndryshuar me Ligj Nr. 86/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014)

Llojet e taksave kombëtare

Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil. (Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë

Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 10 për qind e shumës së primit.

Agjentët e taksave

g) Shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ngarkohen me mbledhjen e taksës mbi primet e shkruara. (Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.) gj) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. (Ndryshuar me Ligj Nr.141/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren zyrtare nr.252, datë 22.01.2016.)